

SHQIP

ANGLISHT

30 DITË

në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Monitorimi i protestës: Matet koha e transmetimit të drejtpërdrejtë në 12 televizione informative

GJETJET E MONITORIMIT PËR OSHMA-TË MBULIMI LIVE PER PROTESTËN 1 - 31 KORRIK 2026		
	KOHA E MBULIMIT TË PROTESTËS (NË ORE)	KOHA E MBULIMIT TË PROTESTËS (NË MINUTA)
01 NEWS 24	134	8,040
02 TOP NEWS	93.05	5,580
03 ORA NEWS	43.68	2,622
04 SYRI TV	42.86	2,574
05 CNA	26.35	1,584
06 FAX NEWS	24.05	1,446
07 A2/CNN	21.78	1,314
08 EURONEWS ALBANIA	15.36	924
09 KLAN NEWS	7.4	444
10 RTSH 24	6.46	390
11 MCN TV	6.05	366
12 REPORT TV	2.23	132

AMA apel qytetarëve: Mos kryeni pagesa, “AlbKanale” jashtë funksionit, kujdes me IPTV-të dhe platformat e paautorizuara

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X

TRANSPARENÇË

AMA – TIK TOK

4 Shkurt - 24 Gusht

2026

Fq. 1

Bashkëpunimi AMA-TikTok: hiqen 107 përmbajtje të dëmshme dhe 1943 materiale pirate

Të dhënat e publikuara gjatë muajit gusht për bashkëpunimin mes qytetarëve, AMA-s dhe TikTok-ut u përditësuan disa herë ...

ANALIZA 6-MUJORE

MONITORIMI I PËRMBAJTJEVE VITI 2026

297 SHQYRTIME TEMATIKE

48 SHKELJE TË IDENTIFIKUARA

TIPOLOGJIA E SHKELJEVE:

22 raste për gjuhë urrëjtjeje dhe diskriminim

13 raste për reklama problematike

6 raste për mbrojtjen e fëmijëve

5 raste për përmbajtje joetike dhe të papërshtatshme

2 raste për mbrojtjen e të dhënave personale dhe jetës private

Fq. 1

ANALIZA 6-MUJORE

KËSHILLI I ANKESAVE

194 ANKESA TË TRAJTUARA

16.5% për dezinformim

12.9% për cenim të imazhit dhe privatisë

11.9% për dhunë verbale dhe fizike

6.7% për interesim lartë të fëmijë

Fq. 1

Këshilli i Ankesave trajtoi 194 ankesa gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026

Analiza e ankesave të publikut tregoi se dezinformimi ishte shqetësimi më i shpeshtë, me ...

AMA apel qytetarëve: Mos kryeni pagesa, “AlbKanale” jashtë funksionit, kujdes me IPTV-të dhe platformat e paautorizuara

Autoriteti u bëri thirrje qytetarëve të përdorin vetëm platforma dhe shërbime televizive të ligjshme. Pirateria mund të shfaqet përmes IPTV-ve të paligjshme, pajisjeve të modifikuara, aplikacioneve dhe faqeve të paautorizuara. Zgjedhja e subjekteve të licencuara mbron të drejtat e transmetimit, publikun dhe funksionimin e qëndrueshëm të tregut mediatic. Ndërkaq, AMA njoftoi bllokimin e aplikacionit pirat “AlbKanale” më 11 gusht 2026, pas monitorimit dhe analizimit teknik nga ekipet e inspektimit. Aplikacioni transmetonte pa autorizim paketat e DigitAlb dhe Tring, kanale televizive dhe përmbajtje sportive. Pas ndërprerjes së shërbimit, operatorët kërkuar kontribute financiare dhe pagesa në kriptomonedha. AMA u kërkoi qytetarëve të mos bënin pagesa, pasi bllokimi ishte rezultat i ndërhyrjes ndaj një shërbimi të paligjshëm. [Lexo më shumë](#)



AMA | AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

GJETJET E MONITORIMIT PËR OSHMA-TË MBULIMI LIVE PËR PROTESTËN 1 - 31 KORRIK 2026

	KOHA E MBULIMIT TË PROTESTËS (NË ORE)	KOHA E MBULIMIT TË PROTESTËS (NË MINUTA)
01 NEWS 24	134	8,040
02 TOP NEWS	93.05	5,580
03 ORA NEWS	43.68	2,622
04 SYRI TV	42.86	2,571
05 CNA	26.35	1,581
06 FAX NEWS	24.05	1,446
07 A2/CNN	21.78	1,314
08 EURONEWS ALBANIA	15.36	924
09 KLAN NEWS	7.4	444
10 RTSH 24	6.46	390
11 MCN TV	6.05	366
12 REPORT TV	2.23	132

Monitorimi i protestës: Matet koha e transmetimit të drejtpërdrejtë në 12 televizione informative

AMA monitoroi mbulimin e transmetimit të drejtpërdrejtë të protestës gjatë 30 ditëve të muajit qershor dhe korrik në 12 televizione informative me shtrirje kombëtare. Në përllogaritje u përfshi vetëm koha kur protesta transmetohej drejtpërdrejt, pa emisionet, komentet apo intervistat në studio. Monitorimi u realizua me të njëjtën metodologji që Autoriteti përdor për proceset zgjedhore, me qëllim pasqyrimin e saktë të kohës reale të transmetimit. [Lexo më shumë](#)



Bashkëpunimi AMA-TikTok: hiqen 107 përmbajtje të dëmshme dhe 1943 materiale pirate

Të dhënat e publikuara gjatë muajit gusht për bashkëpunimin mes qytetarëve, AMA-s dhe TikTok-ut u përditësuan disa herë. Sipas bilancit më të fundit, deri më 24 gusht u administruan 292 ankesa, ndër të cilat 132 përmbajtje ishin në shkelje të ligjit. Nga platforma u hoqën 107 video dhe materiale audio, kryesisht për nxitje dhune dhe urrejtjeje, ekspozim të fëmijëve ndaj përmbajtjeve të dëmshme, akte dhune dhe urrejtje fetare. Gjithashtu u raportuan dhe u fshinë 1943 materiale që cenonin të drejtat e autorit, prej të cilave 1000 foto dhe 943 video.

[Lexo më shumë](#)

Analiza e përmbajtjeve, evidentohen 48 raste shkeljesh



AMA realizoi 297 shqyrtime tematike të përmbajtjeve audiovizive dhe evidentoi 48 raste shkeljesh. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi përbënin kategorinë kryesore me 22 raste, të ndjekura nga 13 raste reklamash problematike, 6 raste që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, 5 raste për përmbajtje joetike dhe 2 raste për cenimin e të dhënave personale dhe jetës private.

[Lexo më shumë](#)



Këshilli i Ankesave trajtoi 194 ankesa gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026


Analiza e ankesave të publikut tregoi se dezinformimi ishte shqetësimi më i shpeshtë, me 16.5% të rasteve. Ai ndiqej nga cenimi i imazhit dhe privatësisë me 12.9%, dhuna verbale dhe fizike me 11.9% dhe çështjet që lidhen me interesin më të lartë të fëmijës me 6.7%. Trajtimi periodik i këtyre të dhënave ndihmon në identifikimin e problematikave të përsëritura, forcimin e standardeve etike dhe rritjen e përgjegjshmërisë së transmetuesve ndaj publikut.

[Lexo më shumë](#)

Gjashtëmujori i parë i vitit 2026, vendosen 9 masa administrative

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, AMA kreu 134 inspektime në subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun audioviziv. Kontrollët u zhvilluan në rrjetet kablore, IPTV dhe OTT, pas ankesave dhe verifikimeve në terren. Si rezultat u vendosën 9 masa administrative me gjobë, 5 për mosrespektim të të drejtave të transmetimit, 2 për moslejim të inspektimit dhe 2 për mosdorëzim të regjistrimeve të kërkuara.

[Lexo më shumë](#)



Në korrik, lajmet politike zunë hapësirën më të madhe në edicionet informative

Të dhënat e monitorimit të AMA-s treguan se gjatë muajit korrik lajmet politike përbënë 15.54% të hapësirës informative në mediat audiovizive. Në vendin e dytë u renditën lajmet sociale me 14.47%, ndërsa lajmet ndërkombëtare përbënë 12.41%. Rezultatet janë pjesë e monitorimit të përmuajshëm të edicioneve informative në radiot dhe televizionet kombëtare.

[Lexo më shumë](#)

